

Studim Sasior

Perceptimet sociale e politike të votuesve në Shqipëri

Përgatitur nga: Data Centrum Research Institute

Tirana, Mars 2023



Objektivi i përgjithshëm i projektit ishte kryerja e një sondazhi për të matur opinionin/perceptimin e votuesve lidhur me:

- 1) mënyrën se si drejtuesit aktualë të pushtetit vendor reflektojnë cilësitë që ata presin prej tyre
- 2) çfarë cilësish presin nga kandidatët që garojnë për zgjedhjet e ardhshme lokale?

Studimi duhej t'i përgjigjej pyetjes kryesore, “Kush është kandidati ideal për të drejtuar një bashki dhe për të zgjidhur problemet e përditshme të qytetarëve?”

Metodologjia e studimit

Metodologjia

Sondazh sasior, me anë të telefonit, duke përdorur një pyetësor të strukturuar në formën e CATI (intervistë telefonike me ndihmën e PC-ve), me kohëzgjatje mesatare të intervistës 12 minuta. Metodë e përzgjedhjes së rastësishme për të zgjedhur të anketuarit (1 në 5 numra kontakti), marrë nga baza e të dhënave të Data Centrum të përfituar nga studimet me përfaqësi kombëtare.

Kampioni

Studim kombëtar, 12 njësitë administrative të Shqipërisë, zona urbane dhe rurale;
 Kampioni përfaqësues n=600 intervista, duke përdorur teknikën e kampionimit me shumë nivele;
 Marzhi i gabimit ± 4% në nivelin e besimit 95%;

Grupi i targetuar


18-75 vjeç, meshkuj dhe femra, banues e votues në zonën respektive;

Norma e përgjigjeve

Datat e intervistave: 3 deri më 15 Mars 2023
 Në total janë kontaktuar 1955 familje për të arritur kampionin e kërkuar, duke arritur një përqindje përfundimtare të përgjigjes prej 30%.



Norma e përgjigjeve





Situata politike dhe ekonomike dhe opinione të përgjithshme

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

Kampioni n=600

Vlerësimi i gjendjes së vendit dhe zonës ku jetojnë


32% e të anketuarve mendojnë se gjendja e vendit në përgjithësi është mirë, ndërsa 42% e tyre mendojnë se gjendja e vendit është keq. Zonat rurale kanë vlerësim paksa më negative për gjendjen e vendit. 39% e qytetarëve mendojnë se gjendja e qytetit ku jetojnë është e mirë, dhe 32% e tyre mendojnë se gjendja në qytete është e keqe. Ndërsa pothuaj 1 në 3 banorë të zonave rurale mendojnë se gjendja e fshatit ku ata jetojnë është shumë e keqe.




Vlerësim mbi ecurinë dhe progresin në zonës ku jetojnë

43% e të anketuarve mendojnë se gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur, ndërsa 42% e tyre mendojnë se po shkojnë në drejtimin e gabuar. Zonat rurale dhe veriu i Shqipërisë kanë vlerësim paksa më negative për progresin e vendit. 36% e qytetarëve mendojnë se gjendja e qytetit ku jetojnë është më e mirë se pjesa tjetër e Shqipërisë, kurse 33% e tyre mendojnë se është më keq krahasuar me pjesën tjetër të vendit. Banorët në veri të Shqipërisë dhe zonat rurale janë më pak të kënaqur me progresin e vendit dhe gjendjen e zones ku jetojnë.

Vlerësimi i progresit në qytetin/fshatin e tyre



Krahasimi i zonës së tyre kundrejt pjesës tjetër të Shqipërisë




Situata në bashkinë (qytetin/fshatin) ku jetojnë!

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë
përqindje %

Kampioni n=600

Kënaqësia me cilësinë e jetës në qytetin/fshatin e tyre


44% e të anketuarve shprehen të kënaqur me cilësinë e jetës në zonën ku banojnë, ndërsa shumica 56% e tyre shprehen të pakënaqur. Banorët e fshatrave dhe ata në zonat veriore kanë pakënaqësi më të theksuar me cilësinë e jetës.



Problemet kryesore në qytetin/fshatin e tyre

Përmendur spontanisht

- Gjendja ekonomike
- Rrugët, infrastruktura rrugore
- Çmimet e larta
- Papunësia
- Shërbimi shëndetsor
- Trafiku dhe mungesa hapësirave për parkim
- Emigracioni
- Mungesa e dritave, ujit
- Ndotja, papastërtia, mbeturinat
- Hapësirat publike, betonizimi i vendit
- Mungesa e investimeve
- Korrupsioni
- Pagat e ulta
- Transporti publik
- Arsimi, shkollat
- Varfëria e popullit, ska shtresë të mesme
- Mbështetja në bujqësi e dobët (mungesa e vaditjes, ndihmë për fermerët)
- Pensionet e ulta
- Tjetër



Të anketuarit kanë përmendur **spontanisht** problemet e mëposhtme si më të rëndësishmet me të cilat ballafaqohet bashkia/qyteti /fshati ku jetojnë:

Gjendja ekonomike (14%), rrugët dhe infrastruktura e tyre (14%), çmimet e larta dhe inflacioni (13%), mungesa e vendeve të punës (13%), shërbimi shëndetësor (11%), trafiku dhe mungesa e hapësirave (11%), si dhe emigracioni (8%) etj.

Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %


6. Cilat janë problemet me të cilat ballafaqohet bashkia/qyteti /fshati ku jetoni dhe në përgjithësi në zonë?

Ju lutem mendoni kërkesat që lidhen me jetën e përditshme, me nevojat e përditshme. Diçka tjetër?

Problemet kryesore në qytetin/fshatin e tyre

Përmendur pas nxitjes

- Papunësia/mungesa e vendeve të punës
- Emigracioni
- Korrupsioni
- Shërbimi shëndetësor
- Taksat lokale
- Infrastruktura rrugore shumë e dobët
- Mungesa e investimeve
- Ndotja/Mjedisi
- Mbeturinat dhe pastërtia e qytetit
- Niveli i krimit
- Transporti publik
- Trafiku dhe mungesa e hapsirave për parkim
- Ngritja e strukturave të tregjeve (oferte/kerkese) apo çmimi i shitjes
- Sistemi i ujitjes, vaditjes së tokave
- Problem në furnizimin me ujë/kanalizimet
- Ndërtimet dhe betonizimi i qytetit
- Mungesa e hapësirës publike (parqe, sheshe)
- Subvencionim për fermerët (plehrat kimike, nafta, farërat)
- Struktura dhe infrastruktura në kopshte dhe shkolla
- Procesi i legalizimit
- Tjetër




Pas nxitjes duke i lexuar një listë me probleme, të anketuarit kanë përmendur problemet e mëposhtme si më të rëndësishmet me të cilat ballafaqohet bashkia/qyteti /fshati ku jetojnë:

Mungesa e vendeve të punës (43%), emigracioni (40%), korrupsioni (28%), shërbimi shëndetësor (19%), Taksat lokale (17%), rrugët dhe infrastruktura e tyre (16%) mungesa e investimeve (14%) etj.


Vlerësimi i punës së bashkisë dhe qeverisë qendrore

56% e të anketuarve mendojnë se puna e bashkisë së qytetit/fshatit ku jetojnë është pozitive, ndërsa më pak, 49% e tyre, mendojnë se puna e qeverisë qendrore ka qenë pozitive gjatë viteve të fundit. Banorët e veriut të Shqipërisë vlerësojnë dukshëm më pozitivisht performancën e qeverisë lokale, krahasuar me atë qendrore.

Vlerësimi i punës së Bashkisë



Vlerësimi i punës së Qeverisë qendrore



Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

8. Si e vlerësoni performancën e bashkisë së qytetit/fshatit tuaj gjatë viteve të fundit?

9. Si e vlerësoni punën e qeverisë qendrore gjatë viteve të fundit?




Rëndësia e punës së bashkisë dhe qeverisë qendrore


Në jetën e përditshme

të anketuarit kanë një mendim të ngjashëm, përsa i përket rëndësisë së punës së bashkisë dhe qeverisë qendrore në jetën e tyre të përditshme, ku pothuaj 8 nga 10 prej tyre mendojnë se të dyja këto institucione janë të rëndësishme.

Rëndësia e punës dhe pranisë së Bashkisë



Rëndësia e punës dhe pranisë së Qeverisë qendrore



Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %


10. Sa të rëndësishme e konsideroni praninë dhe punën e bashkisë në jetën tuaj të përditshme: shumë, mjaft, pak ose aspak?

11. Sa të rëndësishme e konsideroni praninë dhe punën e qeverisë në jetën tuaj të përditshme: shumë, mjaft, pak ose aspak?



Integriteti i përfaqësuesve lokalë


7 nga 10 prej të anketuarve i konsiderojnë përfaqësuesit kryesorë lokale (kryetar/nën kryetar të bashkisë) si njerëz me integritet. 6 nga 10 prej tyre i konsiderojnë anëtarët e këshillit bashkiak si njerëz me integritet, përqindje më e ulët që vjen si shkak i mos njohjes së tyre.



Rëndësia e përfaqësuesve

Për impaktin/zhvillimin e zonës

Shumica e tyre, 56% konsiderojnë kryetarin e bashkisë si të zgjedhurin më të rëndësishëm për impaktin/zhvillimin e zonës, kurse vetëm 31% e tyre mendojnë se deputetët përfaqësues kanë impakt më të madh në zhvillimin e zonës.



Zgjedhjet e ardhshme lokale!


*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë
përqindje %

Kampioni n=600


Njohuria mbi datën dhe rëndësia e zgjedhjeve lokale të 14 Majit

Shumica dërrmuese e të anketuarve, 94% e tyre janë në dijeni se zgjedhjet e ardhshme lokale do të mbahen më Maj. 80% e tyre e dinë datën e saktë, ndërsa 6% nuk janë fare në dijeni se ka zgjedhje lokale. Grupmoshat e reja kanë nivel njohurie më të ulët krahasuar me ato më të mëdha. 9 nga 10 prej tyre i vlerësojnë zgjedhje të tilla si (shumë) të rëndësishme.

Njohuria mbi datën e zgjedhjeve lokale të 14 Majit



Niveli i rëndësisë së zgjedhjeve lokale të 14 Majit



Baza: Të gjithë të anketuarit (600)


*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

14. A jeni në dijeni se në 14 Maj do të mbahen në zgjedhjet lokale në Shqipëri, për të zgjedhur kryetarin e ri të bashkisë?

15. Cili është niveli i rëndësisë për këto zgjedhje lokale?



Rëndësia e zgjedhjeve lokale vs. parlamentare




Shumica e të anketuarve, 59% e tyre mendojnë se si zgjedhjet lokale ashtu dhe ato parlamentare janë njësoj të rëndësishme.

19% e tyre i japin rëndësi më të lartë zgjedhjeve parlamentare, kundrejt 13% të të anketuarve që vlerësojnë zgjedhjet lokale si më të rëndësishme.

8% e tyre mendojnë se asnjë nga zgjedhjet nuk ka rëndësi.

Qëllimi për të marrë pjesë/votuar në zgjedhjet lokale të 14 Majit

Shumica dërrmuese e votuesve kanë qëllim të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme lokale të 15 Majit (83% qëllim pozitiv). Synim paksa më i ulët ndër grupmoshat e reja 18-24 vjeç (77%), e sidomos ndër ata që shprehen se nuk kanë bindje politike, ku vetëm 46% e tyre mendojnë se do të marrin pjesë në zgjedhje.




Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

16. A do të merrni pjesë/të votoni në zgjedhjet e 14 Majit për Kryetarin e ri të bashkisë tuaj?

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

Qëllimi për të marrë pjesë/votuar në zgjedhjet lokale të Majit

Sipas njësive administrative



*Kampion i vogël për Gjirokastrë dhe Kukës (nën 30)/rezultate vetëm indikative


Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

16. A do të merrni pjesë/të votoni në zgjedhjet e 14 Majit për Kryetarin e ri të bashkisë tuaj?

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %


Mundësia e votimit për një kandidat të një partie tjetër

77% e të anketuarve pohojnë se do të votonin për një kandidat që zgjidh problemet e qytetit edhe nëse përfaqëson një parti që ata nuk e mbështesin. Grupi më i ri i moshave 18-24 vjeç dhe ata 55-64 vjeç janë ata që përqafojnë më shumë një ide të tillë. Banorët e veriut të Shqipërisë janë paksa më skeptik kundrejt këtij skenari.



Marrja e vendimit se kë do votojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale

Pothuaj gjysma e respondentëve e di që tani se cilin prej kandidatëve do të votojë. 16% e tyre do e vendosin në javët e fundit, ndërsa 2 nga 10 prej tyre do e vendosin disa ditë para zgjedhjeve. 18% e respondentëve nuk e dinë si do e marrin vendimin kë të votojnë. Grupmoshat e reja deri në 34 vjeç si dhe ata pa bindje politike tregojnë më shumë hezitim mbi vendimin se kë do votojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale.




Këshilli Bashkiak dhe rëndësia e tij!

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë
përqindje %

Kampioni n=600

Perceptimet për Këshillin Bashkiak



19. Sa dakord ose jo jeni me me thëniet e mëposhtme?


Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

Rëndësia e punës së Këshillit Bashkiak

76% e tyre e vlerësojnë punën e këshillit bashkiak si të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e qytetit/fshatit (17% si shumë të rëndësishme)

T2B(3+4)



18. Për sa i përket këshillit bashkiak; sa të rëndësishëm e vlerësoni punën e këtij këshilli për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e qytetit?

Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %


Perceptimi mbi kandidatin për kryetar bashkie

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë
përqindje %

Kampioni n=600

Kandidati ideal për kryetar bashkie

Përshkrim spontan






Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

20. Tani do të doja të imagjinonit kandidatin ideal për kryetar bashkie të zonës suaj. Si do ta përshkruanit ju këtë kandidat ideal? Ju lutem më thoni disa cilësi të tij/saj, sipas pikëpamjes suaj?

Kandidati ideal për kryetar bashkie

Preferenca demografike



Për sa i përket preferencave demografike mbi kandidatin për kryetar bashkie;

Shumica e tyre, 69% shprehen se gjinia nuk përbën ndryshim, ndërsa 18% e tyre do ta donin kandidatin mashkull, dhe 14% femër.

27% e tyre do të donin një kandidat të moshës 31-40 vjeç, 23% e tyre do të preferonin një kandidat 41-50 vjeç, dhe 43% e tyre shprehen se mosha nuk përbën rëndësi për ta.

Edhe pse shumica shprehen se statusi civil nuk ka rëndësi, 34% e tyre do të preferonin një kandidat të martuar, dhe vetëm një pakicë (2%) beqar.


Faktorët vendimtarë

Për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë

Programi i paraqitur (71% gjithsej i përmendur, 25% si më vendimtari), personaliteti i kandidatit (61% gjithsej, 21% më vendimtari) dhe integriteti i kandidatit (61% gjithsej, 20% më vendimtari), aftësia e menaxhimit (44% gjithsej, 10% më vendimtari) janë faktorët më vendimtarë në zgjedhjen se kë të votojnë për kryetar të Bashkisë. Partia dhe lideri i partisë së kandidatit janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm përmendur nga 2 nga 10 respondentë.

1. Programi që prezanton/premtimet që bën
2. Personi/personaliteti i/e kandidatit
3. Integriteti i/e kandidatit (dekriminalizuar, të shkuar të pastër...)
4. Të jetë një menaxher i/e mirë (zgjidhës i problemeve)
5. Partia/koalicioni të cilën përfaqëson
6. Kryetari i partisë të cilën përfaqëson kandidati
7. Kandidat i partisë që është në qeverisje
8. Rekomandimi i familjarëve dhe miqve të mi
9. Ta njoh atë personalisht
10. Premtimet që bën për favore personale dhe familjare –vend pune, etj.
11. Origjina nga një familje e njohur
12. Të ketë të njëjtin besim fetar si unë





Shumica e votuesve mendojnë se është e rëndësishme që një kandidat i fortë të ketë këto cilësi:

1. Të jetë i/e aftë të sjellë investime/punë të reja
2. Të jetë i ndershëm;
3. Të jetë kandidat me integritet;
4. Të përfaqësojë të tashmen, jo të shkuarën;
5. Të ketë programin më të mirë për qytetin si kryetar bashkie;
6. Të respektohet nga komuniteti lokal;
7. Të jetë një menaxher i mirë, me përvojë etj.

Ata e konsiderojnë si më pak të rëndësishëm faktin se cilën parti përfaqëson kandidati, apo çfarë feje ka kandidati. Gjithashtu ata do të donin më shumë një politikan bashkëkohor sesa dikë nga "shkolla e vjetër" e politikanëve.


Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

23. Do të lexoj disa thënie/cilësi dhe do të doja të më tregoni se sa të rëndësishme janë për ju, që këto cilësi ti ketë një kandidat për Kryetar Bashkie që të konsiderohet i/e mirë?

Si e krijojnë opinionin për kandidatët

Shumica e tyre e krijojnë opinionin për kandidatët nga bisedat në familje apo me miqtë/të njohurit, gjithashtu nga televizioni, pra lajmet e programet e ndryshme, apo edhe nga përshtypja e krijuar mbi karakterin e tij. 2 nga 10 prej tyre përdorin edhe mediat sociale, më së shumti grupmoshat e reja.




Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

26. Më tregoni në bazë të këtyre alternativave, ju personalisht, si e krijoni opinion mbi një kandidat për Kryetar Bashkie? LEXO

Prirjet politike

37% e të anketuarve shprehen se kanë bindje politike të majta, dhe 24% e tyre shprehen se kanë bindje të djathta. 16% e votuesve kanë bindje politike të qendrës, dhe po 16% e tyre shprehen se nuk kanë asnjë bindje politike (më së shumti ndër grupmoshat e reja deri më 34 vjeç).



Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %

28. Kur mendoni për prirjet tuaja politike, do të thoni se ju jeni i majtë, i qendrës, apo i djathtë?




Kanalet e informimit mbi partitë dhe politikanët

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë
përqindje %

Kampioni n=600

Kanalet e informimit mbi partitë dhe politikanët

Kanalet më të përdorura të informacionit për partitë dhe politikanët janë televizionet lokale dhe kombëtare, rrjetet sociale të mediave dhe portalet online.
Kanalet digjitale janë më të preferuara nga grupmoshat më të reja në krahasim me grupmoshat më të vjetra.




Baza: Të gjithë të anketuarit (600)

*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %





27. Në cilat nga kanalet e mëposhtme informoheni rreth partive dhe politikanëve?

Profili i të anketuarve


*Të gjitha të dhënat nënkuptojnë përqindje %



Profili i të anketuarve





Të ardhurat familjare (Lek/muaj)



Vendbanimi



Vendbanimi



Përmbledhje e gjetjeve sasiore



Përmbledhje e gjetjeve sasiore

Situata dhe progresi i vendit dhe i zonës ku jetojnë

32% e të anketuarve mendojnë se gjendja e vendit në përgjithësi është mirë, ndërsa 42% e tyre mendojnë se gjendja e vendit është keq. Zonat rurale kanë vlerësim paksa më negativ për gjendjen e vendit. 39% e qytetarëve mendojnë se gjendja e qytetit ku jetojnë është e mirë, dhe 32% e tyre mendojnë se gjendja në qytete është e keqe. Ndërsa pothuaj 1 në 3 banorë të zonave rurale mendojnë se gjendja e fshatit ku ata jetojnë është shumë e keqe.

43% e të anketuarve mendojnë se gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur, ndërsa 42% e tyre mendojnë se po shkojnë në drejtimin e gabuar. Zonat rurale dhe veriu i Shqipërisë kanë vlerësim paksa më negativ për progresin e vendit. 36% e qytetarëve mendojnë se gjendja e qytetit ku jetojnë është më e mirë se pjesa tjetër e Shqipërisë, kurse 33% e tyre mendojnë se është më keq krahasuar me pjesën tjetër të vendit. Banorët në veri të Shqipërisë dhe zonat rurale janë më pak të kënaqur me progresin e vendit dhe gjendjen e zones ku jetojnë.

Cilësia e jetës dhe problemet kryesore

44% e të anketuarve shprehen të kënaqur me cilësinë e jetës në zonën ku banojnë, ndërsa shumica, 56% e tyre shprehen të pakënaqur. Banorët e fshatrave dhe ata në zonat veriore kanë pakënaqësi më të theksuar me cilësinë e jetës.

të anketuarit kanë përmendur spontanisht problemet e mëposhtme si më të rëndësishmet me të cilat ballafaqohet bashkia/qyteti /fshati ku jetojnë:

Gjendja ekonomike (14%), rrugët dhe infrastruktura e tyre (14%), çmimet e larta dhe inflacioni (13%), mungesa e vendeve të punës (13%), shërbimi shëndetësor (11%), trafiku dhe mungesa e hapësirave (11%), si dhe emigracioni (8%) etj.

Pas nxitjes duke i lexuar një listë me probleme, të anketuarit kanë përmendur problemet e mëposhtme si më të rëndësishmet me të cilat ballafaqohet bashkia/qyteti /fshati ku jetojnë:

Mungesa e vendeve të punës (43%), emigracioni (40%), korrupsioni (28%), shërbimi shëndetësor (19%), taksat lokale (17%), rrugët dhe infrastruktura e tyre (16%) mungesa e investimeve (14%) etj.

Vlerësimi dhe rëndësia e punës së bashkisë dhe qeverisë

56% e të anketuarve mendojnë se puna e bashkisë së qytetit/fshatit ku jetojnë është pozitive, ndërsa më pak, 49% e tyre, mendojnë se puna e qeverisë qendrore ka qenë pozitive gjatë viteve të fundit. Banorët e veriut të Shqipërisë vlerësojnë dukshëm më pozitivisht performancën e qeverisë lokale, krahasuar me atë qendrore.

Të anketuarit kanë një mendim të ngjashëm, përsa i përket rëndësisë së punës së Bashkisë dhe Qeverisë qendrore në jetën e tyre të përditshme, ku pothuaj 8 nga 10 prej tyre mendojnë se të dyja këto institucione janë të rëndësishme.

Shumica e tyre, 56% konsiderojnë kryetarin e bashkisë si të zgjedhurin më të rëndësishëm për impaktin/zhvillimin e zonës, kurse vetëm 31% e tyre mendojnë se deputetët përfaqësues kanë impakt më të madh në zhvillimin e zonës.

Zgjedhjet e ardhshme lokale

Njohuria

Shumica dërrmuese e të anketuarve, 94% e tyre janë në dijeni se zgjedhjet e ardhshme lokale do të mbahen më Maj. 80% e tyre e dine datën e saktë, ndërsa 6% nuk janë fare në dijeni se ka zgjedhje lokale. Grupmoshat e reja kanë nivel njohurie më të ulët krahasuar me ato më të mëdha.

Rëndësia

9 nga 10 prej tyre i vlerësojnë zgjedhje të tilla si (shumë) të rëndësishme. Shumica e të anketuarve, 59% e tyre mendojnë se si zgjedhjet lokale ashtu dhe ato parlamentare janë njësoj të rëndësishme. 19% e tyre i japin rëndësi më të lartë zgjedhjeve parlamentare, kundrejt 13% të të anketuarve që vlerësojnë zgjedhjet lokale si më të rëndësishme. 8% e tyre mendojnë se asnjë nga zgjedhjet nuk ka rëndësi.

Qëllimi për të votuar

Shumica dërrmuese e votuesve kanë qëllim të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme lokale të 15 Majit (83% qëllim pozitiv). Synim paksa më i ulët ndër grupmoshat e reja 18-24 vjeç (77%), e sidomos ndër ata që shprehen se nuk kanë bindje politike, ku vetëm 46% e tyre mendojnë se do të marrin pjesë në votime.

Vota për kandidatin nga parti tjetër

77% e të anketuarve pohojnë se do të votonin për një kandidat që zgjidh problemet e qytetit edhe nëse përfaqëson një parti që ata nuk e mbështesin. Grupi më i ri i moshave 18-24 vjeç dhe ata 55-64 vjeç janë ata që përqafojnë më shumë një ide të tillë. Banorët e veriut të Shqipërisë janë paksa më skeptik kundrejt këtij skenari

Marrja e vendimit për kë të votojnë

Pothuaj gjysma e të anketuarve e di që tani se cilin prej kandidatëve do të votojë. 16% e tyre do e vendosin në javët e fundit, ndërsa 2 nga 10 prej tyre do e vendosin disa ditë para zgjedhjeve. 18% e të anketuarve nuk e dine si do e marrin vendimin kë të votojnë. Grupmoshat e reja deri në 34 vjeç si dhe ata pa bindje politike tregojnë më shumë hezitim mbi vendimin se kë do votojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale.

Përmbledhje e gjetjeve sasiore

Perceptimi mbi kandidatin

Kandidati ideal Perceptimi spontan

Perceptimi i të anketuarve për kandidatin ideal përmban disa cilësi të përmendura spontanisht si në vijim: I ndershëm dhe i drejtë (34%), të punojë për popullin (32%), punëtor (18%), i arsimuar/shkolluar (14%), person me integritet (13%), i pa korruptuar/figurë e pastër (10%), i aftë (8%), inteligjent/i zgjuar (7%), të mbajë premtimet (4%), të ketë lindur në të njëjtin qytet/vendali (1%)

Kandidati ideal Preferenca demografike

Për sa i përket preferencave demografike mbi kandidatin për kryetar bashkie;

Shumica e tyre, 69% shprehen se gjinia nuk përbën ndryshim, ndërsa 18% e tyre do ta donin kandidatin mashkull, dhe 14% femër.

27% e tyre do të donin një kandidat të moshës 31-40 vjeç, 23% e tyre do të preferonin një kandidat 41-50 vjeç, dhe 43% e tyre shprehen se mosha nuk përbën rëndësi për ta.

Edhe pse shumica shprehen se statusi civil nuk ka rëndësi, 34% e tyre do të preferonin një kandidat të martuar, dhe vetëm një pakicë (2%) beqar

Faktorët vendimtarë për zgjedhjen si kryetar

Programi i paraqitur (71% gjithsej i përmendur, 25% si më vendimtar), personaliteti i kandidatit (61% gjithsej, 21% më vendimtar) dhe integriteti i kandidatit (61% gjithsej, 20% më vendimtar), aftësia e menaxhimit (44% gjithsej, 10% më vendimtar) janë faktorët më vendimtarë në zgjedhjen se kë të votojnë për kryetar të Bashkisë. Partia dhe Lideri i partisë së kandidatit janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm përmendur nga 2 nga 10 të anketuar.

Rëndësia e cilësive për kandidatin

Shumica e votuesve mendojnë se është e rëndësishme që një kandidat i fortë të ketë këto cilësi;

Të jetë i/e aftë të sjellë investime/punë të reja; Të jetë i ndershëm; Të jetë kandidat me integritet; Të përfaqësojë të tashmen, jo të shkuarën; Të ketë programin më të mirë për qytetin si kryetar bashkie; Të respektohet nga komuniteti lokal; Të jetë një menaxher i mirë, me përvojë etj.

Ata e konsiderojnë si më pak të rëndësishëm faktin se cilën parti përfaqëson kandidati, apo çfarë feje ka kandidati. Gjithashtu ata do të donin më shumë një politikan bashkëkohor sesa dikë nga "shkolla e vjetër" e politikanëve.

Përmbledhje e gjetjeve sasimore

Bindjet politike dhe kanalet e informimit/krijimit të opinionit

Prirjet politike

37% e të anketuarve shprehen se kanë bindje politike të majta dhe 24% e tyre shprehen se kanë bindje të djathta. 16% e votuesve kanë bindje politike të qendrës, dhe po 16% e tyre shprehen se nuk kanë asnjë bindje politike (më së shumti ndër grupmoshat e reja deri më 34 vjeç).

Kanalet e informimit mbi partitë dhe politikanët

Kanalet më të përdorura të informacionit për partitë dhe politikanët janë televizionet lokale dhe kombëtare, rrjetet sociale të mediave dhe portalet online. Kanalet digjitale janë më të preferuara nga grupmoshat më të reja në krahasim me grupmoshat më të vjetra.

Kanalet e krijimit të opinionit

Shumica e të anketuarve e krijojnë opinionin për kandidatët nga bisedat në familje apo/dhe me miqtë/të njohurit, gjithashtu nga televizioni, pra lajmet e programet e ndryshme, apo edhe nga përshtypja e krijuar mbi karakterin e tij. 2 nga 10 prej tyre përdorin edhe mediat sociale, më së shumti grupmoshat e reja.

Summary of quantitative findings



Summary of quantitative findings

The situation and progress of the country and the area where they live

32% of the respondents think that the situation of the country in general is good, while 42% of them think that the situation of the country is bad. Rural areas have a slightly more negative assessment of the situation of the country. 39% of citizens think that the situation of the city where they live is good, and 32% of them think that the situation of the area is bad. While almost 1 in 3 residents of rural areas think that the condition of the village where they live is very bad.

43% of the respondents think that things are going in the right direction, while 42% of them think that things are going in the wrong direction. Rural areas and the north of Albania have a slightly more negative assessment of the country's progress.

36% of the citizens think that the condition of the city where they live is better than the rest of Albania, while 33% of them think that it is worse compared to the rest of the country. Residents in the north of Albania and rural areas are less satisfied with the progress of the country and the condition of the area where they live.

Quality of life and major problems

44% of the respondents are satisfied with the quality of life in the area where they live, while the majority, 56% of them, are dissatisfied. Residents of villages and those in northern areas are less satisfied with the quality of life.

Respondents have spontaneously mentioned the following problems as the most important faced by the municipality/city/village where they live: Economic situation (14%), roads and their infrastructure (14%), high prices and inflation (13%), lack of jobs (13%), health service (11%), traffic and lack of spaces (11%), as well as immigration (8%) etc.

After prompting by reading a list of problems, the respondents mentioned the following problems as the most important ones faced by the municipality/city/village where they live: Lack of jobs (43%), immigration (40%), corruption (28%), health service (19%), local taxes (17%), roads and their infrastructure (16%) lack of investment (14 %) etc.

Evaluation and importance of the work of the municipality vs. government

56% of the respondents think that the work of the municipality of the city/village where they live is positive, while slightly less, 49% of them, think that the work of the central government has been positive during the last years. The inhabitants of the north of Albania evaluate the performance of the local government significantly more positively, compared to the central government.

The respondents have a similar opinion, regarding the importance of the work of the Municipality and the central Government in their daily life, where almost 8 out of 10 of them think that both these institutions are important.

Most of them, 56%, consider the mayor as the most important elected person for the impact/development of the area, while only 31% of them think that the representative deputies have a greater impact on the development of the area.

Summary of quantitative findings

The next local elections

Awareness

The vast majority of respondents, 94% of them, are aware that the next local elections will be held in May. 80% of them know the exact date, while 6% are completely unaware of the local elections. Younger age groups have a lower level of awareness compared to older ones.

Importance

9 out of 10 of them rate such elections as (very) important. The majority of respondents, 59% of them, think that both local and parliamentary elections are equally important. 19% of them give higher importance to parliamentary elections, compared to 13% of respondents who evaluate local elections as more important. 8% of them think that none of the elections matter.

Intention to vote

The vast majority of voters intend to participate in the upcoming local elections on May 15 (83% positive intent). Slightly lower intention among the young age group 18-24 years old (77%), and especially among those with no political beliefs, with only 46% of them claiming they will participate in the elections.

Voting for a candidate from another party

77% of respondents say they would vote for a candidate who solves the city's problems even if he represents a party they don't support. The younger 18-24 age group and those 55-64 are the ones who embrace such idea the most. The inhabitants of northern Albania are a little more skeptical about this scenario

Deciding who to vote for

Almost half of the respondents already know which of the candidates they will vote for. 16% of them will decide in the last weeks, while 2 out of 10 of them will decide a few days before the elections. 18% of the respondents do not know how they will make the decision who to vote for. Young age groups up to 34 years old, as well as those without political beliefs, show more hesitation about the decision of who they will vote for in the next local elections.

Perception of the candidate

Ideal candidate Spontaneous perception

The respondents' perception of the ideal candidate contains several spontaneously mentioned qualities as follows: Honest and fair (34%), work for the people (32%), hardworking (18%), educated (14%), person with integrity (13%), not corrupt/clean image (10%), capable (8%), intelligent/clever (7%), keeps promises (4%), born in the same city/place (1%)

Ideal Candidate, Demographic Preferences

Regarding the demographic preferences on the candidate for mayor; Most of them, 69%, say that gender does not make a difference, while 18% of them would like a male candidate, and 14% a female. 27% of them would like a candidate aged 31-40 years old, 23% of them would prefer a candidate of 41-50 years old, and 43% of them say that age does not matter. Although the majority claim that marital status does not matter, 34% of them would prefer a married candidate, and only a minority (2%) a single one.

Decisive factors for the election as mayor

The presented program (71% overall mentioned, 25% as most decisive), candidate's personality (61% overall, 21% most decisive) the candidate's integrity (61% overall, 20% most decisive) and the management ability (44 % of total, 10% most decisive) are the most decisive factors in choosing who to vote for mayor. The party and the Party Leader of the candidate are also important factors mentioned by 2 out of 10 respondents.

Importance of qualities for the candidate

Most voters think it is important for a strong candidate to have these qualities; to be able to bring new investments/jobs; To be honest; to be a candidate with integrity; to represent the present, not the past; to have the best program for the city; to be respected by the local community; to be a good, experienced manager, etc. They consider as less important which party the candidate represents, or the religion of the candidate. Also they would prefer a contemporary politician rather than someone from the "old school" of politicians.

Political beliefs and channels of information/opinion creation

Political beliefs

37% of the respondents claim they have left-wing political beliefs, and 24% of them have right-wing beliefs. 16% of voters have central political beliefs, and 16% of them say they have no political beliefs at all (mostly among the young age group up to 34 years old)

Channels of information about parties and politicians

The most used channels of information about parties and politicians are local and national television, social media networks and online portals.

Digital channels are more preferred by the younger age group as compared to the older age group.

Channels of opinion formation

Most of them form their opinion about the candidates from conversations in the family or with friends/acquaintances, also from television, i.e. the news and various programs, or even from the impression created on his character.

2 out of 10 of them also use social media, mostly the younger age group.



KOMPONENTI CILËSOR

Metodologjia e kërkimit



Studim cilësor në formën e fokus-grupeve (FG) me përdorimin e një udhërrëfyese gjysëm të strukturuar; kohëzgjatja mesatare e diskutimit 2 orë

Total 2 fokus grupe
Ndarje moshore 18-24, 35-45, vjeç

Profili i pjesëmarrësve: Banorë në qytetin e Tiranës, meshkuj dhe femra, votues dhe jo votues, moshë 18-45 vjeç

Mbledhja e të dhënave cilësore (FG): 20 – 21 Mars 2023

Data Centrum, anëtar zyrtar i ESOMAR (European Society for Opinion and Market Research) respekton dhe zbaton të gjitha dispozitat e Kodit Ndërkombëtar të Studimeve të Tregut, Opinioni dhe Kërkimit Social dhe Analizës së të Dhënave, si dhe zbaton standardet e cilësisë së punës në terren të ESOMAR.

Situata e përgjithshme në Shqipëri

Perceptimi i pjesëmarrësve në focus group për gjendjen aktuale të Shqipërisë instiktivisht anon më tepër nga drejtimi i gabuar, e megjithatë 3 nga 16 pjesëmarrës kanë cilësuar disa gjëra pozitive.

Drejtimi i duhur

- Përmirësimi i infrastrukturës së spitaleve.
- Përmirësimi i infrastrukturës në çerdhe, kopshte, shkolla.
- Përmirësimi i infrastrukturës në qendrat e qyteve.
- Infrastruktura rrugore dhe aeroportet.
- Komunikimi në administratë. Pranimi dhe trajtimi i ankesave të popullit.

“Janë shtuar godinat e kopshteve dhe shkollave me kushte më të mira”.

Drejtimi i gabuar

- Emigrimi masiv.
- Mungesa e meritokracisë
- Arsimi në nivele shumë të ulëta. Shumë degë janë drejt mbylljes.
- Rritja e inflacionit.
- Korrupsioni.
- Pagat e ulëta.
- Transporti urban.
- Ndërtime të shumta, kulla shumëkatëshe.
- Trafiku i rënduar, parkimi.

“Nuk ka shpresa që ky vend do bëhet ndonjëherë”

Kujt i atribuohet gjendja në Shqipëri:

Drejtimi i duhur

- ✓ Shumica e pjesëmarrësve ja atribuojnë suksesin taksave të qytetarëve dhe një pjesë tjetër bashkisë.
- ✓ 8 nga 16 pjesëmarrës edhe pse opinionin e përgjithshëm e kanë negativ, atributet për gjërat që po shkojnë në drejtimin e duhur ja atribuojnë qeverisë.

Drejtimi i gabuar

- ✓ Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit fajësojnë klasën politike për ecurinë në drejtimin e gabuar të vendit.
- ✓ Një pjesë e tyre fajësojnë qeverinë por vihet re se 2-3 pjesëmarrës fajësojnë edhe popullin për mungesën e kulturës dhe mentalitetit.

Klasat politike ndër vite.

Situata në bashkinë (qytetin/fshatin) ku jetojnë!

Pjesëmarrësit instiktivisht shprehen se gjërat në zonat ku banojnë nuk po shkojnë në drejtimin e duhur. Ata të cilët janë të ardhur në qytetin e Tiranës bëjnë një krahasim edhe më të theksuar të situatës aktuale.



'Ka qënë me ngjyra, është pa ngjyra. Ka pasur gjallëri, dinamizëm dhe njerëz më optimistë'

Situata aktuale në lagjen tuaj

- ✓ Emigrimi masiv jashtë vendit.
- ✓ Shpopullimi nga qytetet dhe fshatrat drejt kryeqytetit.
- ✓ Mungesa e vendeve të punës.
- ✓ Turizmi i pazhvilluar aq sa duhet.
- ✓ Niveli i jetesës shumë i ulët.

Sfidat e përditshme të qytetarëve

Trafiku/Parkimi

- ✓ Pothuajse 14 nga 16 pjesëmarrës sfidën më të madhe në përditshmërinë e tyre hasin trafikun. 2 prej tyre për shkak të kësaj situate zgjedhin rrugën e biçikletave për të qarkulluar.
- ✓ Parkimi gjithashtu është një shqetësim tjetër i tyre. Përveçse nuk gjejnë vend për të parkuar por gjithashtu dhe duhet të paguajnë kudo që shkojnë.

Transporti Urban

- ✓ Për grupmoshën e re shqetësim mbetet kryesisht transporti urban. Mbingarkesa nëpër urbane, oraret dhe vonesat e tyre, mirëmbajtja, mos menaxhimi i flukseve në fashat e orareve të lëvizjes më të madhe të qytetarëve sjell një shqetësim të madh për ta.

Aktivitetet sociale/kulturore

- ✓ Për grupmoshën e dytë, sidomos për ata që janë familjarë sfidë është mungesa e aktiviteteve për të rinjtë dhe fëmijë. Ato që janë, siç përmendin aktivitetet pas shkollës dhe qendrat pas-shkollore, janë goxha të kushtueshme dhe të papërbalueshme nga pjesa më e madhe.

Mungesa e hapësirave publike

- ✓ Në zona të ndryshme banimi, 10 nga 16 pjesëmarrës kanë mungesë të hapësirave publike, të vendeve poshtë pallateve për të luajtur fëmijët.
- ✓ Rrugët dhe trotualet për këmbësorët janë shumë të ngushta për shkak të ndërtimeve të komplekseve të mëdha.

“Në lagje s’ka parqe. Del nga hyrja e pallatit dhe direkt je në rrugë, burim aksidenti. Në Tiranë i vetmi park është liqeni ku dhe aty s’del dot se është i mbipopulluar”.

Partitë politike dhe Politikanët

Situata e Partive Politike

- ✓ Perceptimi kryesor i pjesëmarrësve është ndryshimi i të gjitha figurave politike që janë aktualisht.
- ✓ Mendojnë se për afëra politiko-ekonomike janë të lidhur me njëri-tjetrin.
- ✓ Besueshmëria tek këto figura është shumë e ulët, pasi nuk kanë mbajtur premtimet e dhëna gjatë fushatave elektorale.
- ✓ Nuk shikojnë asnjë përmirësim dhe nuk kanë shpresë se do e ndryshojnë vendin për mirë.
- ✓ Nuk lënë hapësira për politikanë të rinj që mund të sjellin ide të reja, frymë të re, zhvillim apo ndryshim.

Politikanët. Përshtypje e përgjithshme:

- ✓ 3 nga 16 pjesëmarrës cilësojnë si më të pëlqyer Sali Berishën për arritjet që ka bërë në kohën kur ka qënë në pushtet. Mendojnë që ka sjellë zhvillim të vendit dhe ekonomisë.
- ✓ Më pak i pëlqyer është Erion Veliaj, kryetari aktual i bashkisë dhe njëherësh edhe kandidati për zgjedhjet e ardhshme të 14 Majit.
- ✓ Disa prej tyre përmendin si të preferuar edhe Erion Braçen, pasi e cilësojnë si një njeri që ka dhënë kontribut dhe e mbron komunitetin e tij.

Karakteristikat që duhet të ketë një politikan

Të ketë
transparencë në
taksat e popullit.

Të jetë i
ndershëm,
realist.

Punëtor për të
mirën e vendit.

Të punojë për
problemet e
njerëzve.

Të jetë i
arsimuar.

Menaxher i
mirë.

Të përfaqësojë
popullin,
mos të jetë vetëm
fasadë.

Të mbajë
premtimet e
dhëna.

Opiniononi për partitë politike...



1. Eshtë bërë akoma dhe më e fuqishme.
2. Ka krijuar kushtet optimale.
3. Me anë të korrupsionit ka forcuar akoma më shumë lidhjet.
4. Duke patur një opozitë të dobët ka akoma më shumë mundësi të fitojë dhe të jetë gjatë në pushtet.
5. Përçarja e PD-së e bën akoma më të vështirë ikjen nga pushteti.



1. Instiktivisht ju vijnë ndërmend emrat e Sali Berishës dhe Lulzim Bashës.
2. Në kohën e PD-së situata ekonomike ka qënë më mirë.
3. Eshtë dobësuar, është ndarë, ndikon negativisht.
4. Nuk përbën më konkurrencë për Partinë Socialiste.



1. Ka ndikim të fortë në disa zona.
2. Ndryshon krahët politikë, sa majtas-djathtas vetëm për të ardhur në pushtet.
3. PL është mënyra sesi mund të bësh korrupsion.

Grupi i të rinjve kanë shumë pak informacion lidhur me këtë parti politike.

Perceptimi mbi zgjedhjet e 14 majit

- ✓ Të pyetur mbi njohurinë për zgjedhjet e 14 majit shumica e tyre e dinë që ka zgjedhje.
- ✓ Ndërkohë 4 nga 16 pjesëmarrës nuk do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale që do të mbahen më 14 maj.

- ✓ Pyetjes se pse nuk votojnë, ata i përgjigjen se janë të mërzitur dhe të lodhur nga politikanët dhe situata politike.
- ✓ Të rinjtë shprehen se edhe nëse ju duhen të vendosin për të votuar kryesisht ndikohen nga familja.

(“90% e shqiptarëve votojnë sipas një historie familjare”)

Kandidatët për zgjedhjet e 14 majit (atributet pozitive dhe negative të secilit)

Erion Veliaj

- ✓ Disa persona shprehen se ka marketing shumë të mirë dhe ka artikulacion të mirë. Këto cilësi i atribuohen skuadrës që ka.
- ✓ Ndërkohë që mes tyre ka dhe individë që kanë mendim negativ.

Belind Këlliçi

- ✓ Pozitive shikohet formimi, arsimi.
- ✓ Komunikimin e ka shumë të mirë.
- ✓ Eshtë i shkathët.
- ✓ Pjesa më e madhe nuk kanë informacion.
- ✓ Nuk ka dhënë kontribut.

Kandidatët për zgjedhjet e 14 Majit (atributet pozitive dhe negative të secilit)

Integriteti i kandidatëve

- ✓ Publiku i gjerë (e thënë nga pothuaj të gjithë pjesëmarrësit) nuk i njeh me aq detaje sa për të dhënë një gjykim të pastër dhe racional.
- ✓ Por, grupmosha e të rinjve janë shprehur se nuk kanë fare simpati për kandidatin Erion Veliaj, pasi e cilësojnë punën e tij fasadë dhe tallje të hapur ndaj popullit.
- ✓ Marketing-u që ai bën është mënyra më e mirë për të marrë pushtetin.
- ✓ Nga ana tjetër pavarësisht se nuk e njohin shumë mirë figurën e Belindit si kandidat i atribuojnë atij disa cilësi pozitive si individ.

Influencat ndërkombëtare

- ✓ Janë thjesht vëzhgues. Disa shprehen se ndërkombëtarët nuk duan të na shikojnë mirë.
- ✓ Nëse duan të ndërhyjnë, nuk ja u pranon kushtetuta.
- ✓ Disa persona shprehen se po të kishin influencë do *“ti kishin ndryshuar kandidatët”*.
- ✓ Ndërkohë të tjerët shprehen se sado në mënyrë jo zyrtare, kanë ndikim në parti të ndryshme.

Këshilli Bashkiak

- ✓ 8 nga 16 pjesëmarrës nuk kanë asnjë informacion se çfarë funksioni ka Këshilli Bashkiak.
- ✓ Disa prej tyre i quajnë thjesht militantë.

Prirjen drejt anonimatit, pa Kontribute, pa angazhime.

Vendimet e Këshillit Bashkiak

- ✓ Nuk është një organ funksional.
- ✓ Nuk kanë informacion për mbledhjet që bëjnë dhe vendimet që marrin.

Mungesë transparencë
për vendimet

- *Prishja e mbikalimit të Zogu i Zi*
- *Busti i Azem Hajdarit tek Taiwan.*

Anëtarët e Këshillit Bashkiak

- ✓ Duhet të jenë njohës shumë të mirë të politikave, ekonomisë, ligjit.
- ✓ Njohës shumë i mirë i popullit dhe problematikave.
- ✓ Duhet të sjellin ide të reja.

KANDIDATI IDEAL PËR KRYETAR BASHKIE



Opinionimi i pjesëmarrësve sesi do ta përkufizonin ata kandidatin ideal, nga të 2 grupmoshat është i njëjtë.



- I arsimuar
- Të përfaqsojë komunitetin e tij
- Të përfaqësojë vullnetin e popullit.
- Të mbështesë shtresat e varfra, familjet në nevojë.
- Të ketë pjekuri dhe të jetë i drejtpërdrejtë.
- Të ketë integritet.
- Të punojë me ndershmëri.

“Nëse ne jemi të bindur që ai është i ndershëm dhe është lodhur për të arritur deri në këtë pikë, patjetër që do ta votojmë.”

Thank you for your trust!

DATACENTRUM
RESEARCH INSTITUTE

Independent private research agency

Str. "Ilo Mitkë Qafëzezi", Building No.11, Tirana 1060

T. +355 (0)44506363 / 42201100

Web. www.datacentrum.al

ESOMAR
member



Ms. Sonila Çela

General Director

s.cela@datacentrum.al

T. +355 (0)42201100

M. +355 (0) 67 200 0022

